



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.SH.T. "Kadria-NET"
Nr. i biznesit 70765608
Pronar – Kadri HAXHIAJ
OK "Kadria-Net"
Istogë

Ref: 1506/846/LIC/ni

Vendim

për licencimin e Operatorit Kabllor, "Kadria-Net" me seli në Komunën e Istogut

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Kandidati "Kadria-Net" ka aplikuar për licencë të KPM-së, për operatorë kabllorë, më datën 12 qershor 2015.

Arsyetim

3. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
4. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "*për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja*".
5. Komisioni vlerëson se, kandidati "Kadria-Net" ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator kabllor, në pajtueshmëri me Nenin 7 të Rregullores CIMC 2007/04.

6. Me Rregulloren CIMC 2007/04 nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator kabllor. Prandaj, Komisioni vlerëson se, një operator kabllor mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve, ndërsa kandidati "Kadria-Net" ka dorëzuar një listë prej 35 kanaleve.
7. Kandidati për operator kabllor "Kadria-Net" do të ketë të drejtë të bart, në pakon e tij programore, vetëm kanalet televizive për të cilat posedon marrëveshje mbi të drejtën e autorit për bartjen e kanaleve përmes rrjetit kabllor.
8. Pas pajisjes me licencë të KPM-së, kandidati për operator kabllor "Kadria-Net" mund të sigurojë marrëveshje shtesë për bartjen e programeve në rrjetin e tij kabllor, dhe mund të zgjerojë listën e programeve në të ardhmen. Kandidati "Kadria-Net" obligohet t'i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja për zgjerim të listës programore, sapo t'i ketë siguruar ato.
9. Komisioni, vlerëson se "Kadria-Net" ka paraqitur aplikacionin në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara me Rregulloren CIMC 2007/04 si dhe me Rregulloren e KPM-së KPM-2013/04.
10. Komisioni vlerëson se, kandidati për operator kabllor "Kadria-Net" ka përmbushur kriteret për kualifikim për t'u pajisur me licencë të KPM-së.

Vendim

11. Në takimin e mbajtur më datën 22 korrik 2015, Komisioni merr vendim që, kandidatit "Kadria-Net" i cili planifikon të operojë në Komunën e Istogut, t'i lëshojë licencën e KPM-së për operatorë kabllorë, për të ofruar shërbime të programeve përmes operatorit kabllorë, për të cilat posedon marrëveshje valide për transmetim përmes sistemit kabllor.

Lëshimi i Vendimit

12. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij. Kandidati mund të fillojë veprimtarinë e tij si operatorë kabllorë vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës së KPM-së.


Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

05.08.2015

datë